



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**A.nr.624/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatëve Jollxhi Shala, Rejhan Podrimja, Rexhep Pecora, Muhamet Krasniqi, Alma Bajrami, Dardan Morina, nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, me seli në Prizren, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.03.2025, merr këtë:

#### **V E N D I M**

**HEDHEN TË PALEJUESHME** ankesat A.nr.624/2025, Anr.625/2025, Anr.626/2025, Anr.627/2025, Anr.628/2025, Anr.629/2025 të datës 03.03.2025, të parashtruara nga kandidatët Jollxhi Shala, Rejhan Podrimja, Rexhep Pecora, Muhamet Krasniqi, Alma Bajrami, Dardan Morina, nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, me seli në Prizren, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Prizrenit, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 03.03.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat A.nr.624/2025, Anr.625/2025, Anr.626/2025, Anr.627/2025, Anr.628/2025, Anr.629/2025, të parashtruara nga kandidatët për deputet Jollxhi Shala, Rejhan Podrimja, Rexhep Pecora, Muhamet Krasniqi, Alma Bajrami, Dardan Morina, nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, me seli në Prizren, në të cilat ankesa kërkohet rinumërimi i të gjitha kutive në Prizren për arsye se kamerat nuk kanë qenë të vendosura në mënyrë të duhur, dhe për këtë arsye votat e tyre si kandidat nuk janë të mjaftueshme, dhe se arsyeja është se kamerat nuk kanë qenë të fokusuar në mënyrë të duhur në fletëvotim, ku sipas kandidatëve është shkelur pika 1 e nenit 17 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.16 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.624/2025, Anr.625/2025, Anr.626/2025, Anr.627/2025, Anr.628/2025, Anr.629/2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.624/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga kandidatët për deputet Jollxhi Shala, Rejhan Podrimja, Rexhep Pecora, Muhamet Krasniqi, Alma Bajrami, Dardan Morina, nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës,, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesat ka gjetur se :

*- Ankesat janë të pasafatshme me këtë rast konsiderohen të palejueshme.*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se kandidatët Jollxhi Shala, Rejhan Podrimja, Rexhep Pecora, Muhamet Krasniqi, Alma Bajrami, Dardan Morina, nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, kanë dorëzuar ankesë në PZAP më datën 03.03.2025, ku kanë pretenduar se votat e tyre si kandidat nuk janë të mjaftueshme, dhe se arsyeja është se kamerat nuk kanë qenë të fokusuar në mënyrë të duhur në fletëvotim, gjatë numërimit të votave në QKN në Komuna Prizren.


Megjithatë, ankesat janë parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen, me shkrim pran PZAP-it, brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ankesa është dorëzuar në PZAP me datë 03.03.2025, ndërsa procesi i numërimit në QKN Prizren është përfunduar më datë 19.02.2025 në ora 17:20, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor prej 48 orëve.

Paneli, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Jollxhi Shala, Rejhan Podrimja, Rexhep Pecora, Muhamet Krasniqi, Alma Bajrami, Dardan Morina, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, *ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen*, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

A.nr. 624/2025 datë 04.03.2025



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.